

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

844-1  

---

14198

Meto  
Muho

Dasme  
partizane

vjersha



Ka lindur në Lekdush të Kurveleshit më 1923 në një familje të varfër fshatare. Qysh në moshë të re ka punuar për shërbyes dhe punëtor. Më 1942 hyri në Lëvizjen nacionalçlirimtare dhe mori pjesë në aksionet kundër ushtrisë fashiste. Në 1943 doli partizan, në batalionin «Margarita Tutunani» dhe pastaj në batalionin «Abaz Shehu» të Brigadës VI Sulmuese. Mori pjesë në gjithë luftimet që zhvilloi brigada duke kaluar edhe në tokat e Jugosllavisë. Ka luftuar edhe në provokacionet e gushtit të vitit 1949.

Ky është vëllimi i tij i dytë me vjersha.

854-1  
MSP

METO MUHO

# DASMË PARTIZANE

— vjersha —



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

Redaktor: VEHBI SKËNDERI

Kopertina nga: MUSA QARRI

Tirazhi 1.500 kopje      Format 70x100/32      Stash: 2204-72

---

Shtyp. Drejtoria Qendrore Poligrafike  
Shtypshkronja «8 NENTORI» — Tiranë, 1973

## **BIE BORA FLOKË—FLOKË**

Bie bora flokë-flokë dhe nuk ndihet,  
s'duket qiell, s'duket tokë, moti nxihet;  
s'shuhen zjarret partizane dhe pse bie,  
janë xhveshur ngrohen trimat në korie.

Dyshek borën nënëvete kanë shtruar,  
jorgan një xhaketë ushtari të arnuar,  
mbathur opinga lëkure shoshë çpuar,  
pushkën mbështjellë pëqirit fort shtrënguar.

Pyjet me degët e tyre streh' u bënë.  
Kudo çerdhe trimërie kanë qënë.

27 dhjetor 1943

## NDRIT VEPRA E DËSHMORËVE

Zhulati i vogël në grykë  
në mes të dy maleve,  
pranë rrapit shkëlqen ylli,  
ndrit vepra e dëshmorëve.

Shtatë dëshmorë të rënë,  
dhanë jetën për Atdhe  
përmbi gjakun e kulluar  
lulëzon jeta e re.

Cilin të përmend më parë?  
Hasani ish shumë i ri;  
djalë i vetëm i nënesë  
atje mbi Senicë u shtri.

Mahmuti si vetëtima  
çau përmes plumbave,  
kur po hipte te bunkeri  
u godit e ra përdhe.

Axhem Çela me Rushanë  
tek sulmonin me furi,  
përmbi tela në Tiranë  
derdhën gjakun për liri.

Hamiti ish trim i rrallë,  
komandant në kompani,  
në sulm u godit në ballë  
ra dëshmor në Mal të Zi.

## ITALIANI S'DI KU SHKON

Majë malit është Picari,  
Gjirokastra për karshi,  
si rrufe shpërtheu zjarri,  
Shefqet Peçi bën kërdi.

Kur dëgjohet tej Shefqeti,  
që po vjen me batalion,  
tundet vendi si tërmeti  
italiani s'di nga shkon.

Shefqeti vjen që nga Kota  
del me brigad' në Dalan  
filloi që të dridhet toka  
dhe për të famshmin gjerman.



## LABJA BUZEQESHUR

Tetë ditë me radhë  
qëndruan pa ngrënë,  
vëndi plot nazistë,  
shtigjet kishin zënë.

Një shtëpi çobani  
ishte përkarshi,  
nuk dukej nga shqopet,  
tani ra në sy.

Atje miell s'gjetën  
as për një kulaç,  
fëmijët t'uritur  
shikonin mbi saç.

Labja buzëqeshur,  
shokët sa i pa,  
tepsinë me lakëra  
nxori e ua dha.

SHKËMBIMET E ANKESË

Shokët e mi, këtu  
është një letër e re  
që t'ju dërgoj me kënaqësi  
për t'ju tregoj se si  
është shpirtërisht e re.

Shokët e mi, këtu  
është një letër e re  
që t'ju dërgoj me kënaqësi  
për t'ju tregoj se si  
është shpirtërisht e re.

Shokët e mi, këtu  
është një letër e re  
që t'ju dërgoj me kënaqësi  
për t'ju tregoj se si  
është shpirtërisht e re.